



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Nr. 269 Dt. 24.06.2014

PRISHTINË • PRISTINA • PRIŠTINA

Ne bazë të nenit 65 të Rregullores Disiplinore të FBK 06.9.2008, Komisioni Disiplinor me datë 24.6.2014 merre këtë

## VENDIM

- I. Ruzhdi Kuqi, delegat i FBK nga Theranda, i shqiptohet masa disiplinore e ndalesës në kryerje të detyrës në të gjitha aktivitetet e FBK në afat prej tre (3) muajsh.

### Arsyetim

Komisioni Disiplinor, ka pranuar Fletëparaqitjen e FBK me Ref. Nr. 248 datë 28.5.2014 për inicim të procedurës disiplinore ndaj z. Ruzhdi Kuqi, delegat i FBK nga Theranda për shkelje të supozuar si në vazhdim:

- Kapje për kollare vëzhguesin e ndeshjes, duke e ofenduar në mënyrën më brutale, ofendim i gjyqtarëve dhe kontrollorit të ndeshjes si dhe fyerje ndaj kryetarit dhe të gjitha organeve të FBK-së, sjellje e cila ka ndodhur në ndeshjen e dytë të PLAY-OUT-it, **YLLI - KASTRIOTI**, e zhvilluar më 26.5.2014 në Therandë

Komisioni me datën 24.6.2014 në pajtim me nenin 32 të Rregullores për Procedura Disiplinore, ka shqyrtuar Fletëparaqitjen me Ref. Nr. 248 datë 28.5.2014, provat materiale të ofruar nga FBK, Deklaratën e z. Ruzhdi Kuqit të pranuar me anë të postës elektronike më datë 06.9.2014, dokumentacionin tjetër përcjellës si dhe ka marrë për bazë nenin 25 të Rregullores për Procedurat Disiplinore që ka të bëjë me rrethanat lehtësuese, me ç'rast morri vendim duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, sepse

ndaj z. Ruzhdi Kuqi, është ofruar dëshmi dhe prova relevante që vërtetojnë se të përmendurit duhet shqiptuar masa disiplinore.

Komisioni Disiplinor i FBK, pas administrimit të provave, dëshmime të ofruara dhe duke u bazuar në aktet normative në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Komisionit Arbitrar të FBK në afat prej tri ditësh nga dita e marrjes së këtij Vendimi.

**Komisioni Disiplinor:**

1. Fidan Hamiti

2. Nuredin Ibishi

3. Lulzim Fushtica



**Vendimi t'i dërgohet:**

1. Te përmendurit,
2. Klubit përkatës,
3. Zyrës së FBK,
4. Anëtarëve të KD, dhe
5. Dosjes së kësaj lënde.

